

Data 11/10/2023

**PROCESVERBAL – TIPI KONTRATËS – SHËRBIME  
(PROCEDURË E HAPUR)  
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** *"Shërbimi i printimit dhe fotokopjimit për KESH sh.a, zyrat qëndrore dhe njësitë e prodhimit".*

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**  
*Shërbime të tjera- 98390000-3.*

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 14,800,000 (Katërmëdhjetë milion e tetëqind mijë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare, KESH sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

**Argumentimi:**

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetë deklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertës" të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar. Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" citohet: "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetë deklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetë deklaramit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit.

*Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomik arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.*

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43 pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”.

Duke marrë në konsideratë specifikën e objektit procedure prokurimi, kërkohet që Operatorët Ekonomik ofertues të paraqesin vërtetime të cilat vërtetojnë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të realizuar këtë procedure prokurimi në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

## **Aftësitë teknike dhe profesionale:**

---

**2.3.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

**a)** Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**b)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

#### **Argumentimi:**

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim / letër angazhimi / akt marrëveshje bashkëpunimi me prodhues ose distributor të autorizuar nga prodhuesi për software të menaxhimit të printimit dhe pajisjeve të ofruara.

*Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit*

#### **Argumentimi:**

Kërkesa për paraqitjen e autorizim / letër angazhimi / akt marrëveshje bashkëpunimi me prodhues ose distributor të autorizuar nga prodhuesi për software të menaxhimit të printimit dhe pajisjeve të ofruara është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës. Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**2.3.3** Operatori Ekonomik duhet të ofrojë zgjidhje teknike e cila duhet të jetë në përputhje me Termat e Referencës.

*Për plotësimin e këtij kriteri Operatori Ekonomik duhet të paraqesë zgjidhjen teknike si do të realizojë zbatimin në përputhje me Termat e Referencës.*

**Argumentimi:**

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në Termat e Referencës, ku Operatori Ekonomik duhet të paraqesë zgjidhjen teknike si do të realizojë zbatimin e shërbimit në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara në Termat e Referencës.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar për periudhën Gusht 2023 minimalisht 6 (gjashtë) punonjës nga të cilët:

- minimalisht 3 (tre) punonjës të çertifikuar nga prodhuesi i pajisjeve ose institucione të autorizuara;
- minimalisht 1 (një) punonjës të çertifikuar nga prodhuesi ose institucione të autorizuara për instalimin dhe konfigurimin e software të menaxhimit të printimit;
- minimalisht 1 (një) punonjës të çertifikuar për planifikimin, analizimin dhe implementimin e shërbimeve të menaxhuara të printimit;
- minimalisht 1 (një) punonjës të çertifikuar për sigurinë informatike të ndërhyrjes në sisteme;

**Sqarim:** Pranohen rastet kur një punonjës disponon më shumë se një çertifikatë, por në mënyrë të kombinuar stafi duhet të plotësojë minimumin e çertifikatave/dëshmime të kërkuar.

*Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:*

- ✚ Kontratë pune të vlefshme;
- ✚ Çertifikatat;
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Gusht 2023.

**Argumentimi:**

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

## **Konkretisht :**

- 6 (gjashtë) punonjës janë kërkuar pasi objekti i prokurimit është shërbimi i printimit dhe fotokopjimit të përqendruar në zyrat qendrore të KESH SH.A në Tiranë, në njësitë e prodhimit HEC Vau i Dejës, HEC Koman dhe HEC Fierzë si dhe në magazinën qendrore në Shkozet-Durrës sipas volumeve të ndara në Termat e Referencës për një periudhë 4 (kater) vjeçare.
- Punonjësit e certifikuar janë kërkuar referuar Termave të Referencës:

Duke patur parasysh kompleksitetin e teknologjive, sasinë e pajisjeve dhe shpërndarjen gjeografike, kërkohet një menaxhim i mirëplanifikuar i shërbimeve që mbulon kontrata. Operatori Ekonomik duhet të përcaktojë stafin përgjegjës menaxherial dhe teknik sipas përgjegjesive duke caktuar pikat e kontaktit për zhvillimin e shërbimit, raportimet dhe monitorimin e performancës. Të gjitha problemet që lindin gjatë afatit të kontratës duhet të menaxhohen dhe zgjidhen nga stafi i certifikuar i ofruesit të shërbimit. Procesi i riparimit dhe ndërhyrjes në këto pajisje brenda ambjenteve të institucionit, mbart me vete rrezikshmëri, ndaj edhe kërkohet që të mirëmenaxhohet shërbimi i servisit duke ndjekur me përpikmëri të gjitha rregullat e sigurimit teknik.

3 (tre) punonjës të certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve ose institucione të autorizuara: Janë të nevojshëm pasi OE është përgjegjës për shërbimin historik të pajisjeve të ofruara për të maksimizuar disponueshmërinë. Zëvendësimi i materialeve të konsumit, përveç toner do të planifikohen në lidhje me shërbimet periodike të mirëmbajtjes së pajisjeve. OE do të jetë përgjegjës për sasinë e stokut për funksionimin pa ndërprerje. OE duhet të krijojë një bazë të të dhënave për pajisjet e instaluar për të pasur një historik të disponueshmërisë për çdo pajisje. Sipas të dhënave të ofruara nga software i menaxhimit, OE do të planifikojë dhe të kryejë në kohën e duhur shërbimet periodike për mirëmbajtjen e pajisjeve. OE duhet të vlerësojë performancën dhe mund të sugjerojë për përmirësimin e funksionimit, zgjerimit, përmirësimin ose heqjen e pajisjeve që synojnë rritjen e produktivitetit.

Duke qënë se mirëmbajtja e pajisjeve kryhet fizikisht është kërkuar një numër prej 3 (tre) punonjësish për mirëmbajtje/riparim pajisjesh duke marrë parasysh shtrirjen gjeografike të pajisjeve dhe numrin e tyre, gjithashtu edhe projekte që kompania mund të ketë paralelisht. Duke pasur një numër të madh punonjësish për mirëmbajtje/riparime të pajisjeve sigurohet shpejtësia e shërbimit.

1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi ose institucione të autorizuara për instalimin dhe konfigurimin e software të menaxhimit të printimit: Është i nevojshëm pasi sistemi i menaxhimit të Printimit konsiston në furnizimin, instalimin, vënien në funksion si dhe bashkëveprim të kordinuar të tre komponentëve të përcaktuar në Termat e Referencës ku përfshihet *Komponenti "Software"* ku përfshihen programet dhe aplikimet të cilat do të menaxhojnë pajisjet dhe do të japin të drejtat dhe kufizimet për përdoruesit.

1 (një) punonjës të certifikuar për planifikimin, analizimin dhe implementimin e shërbimeve të menaxhuara të printimit: Është i nevojshëm duke patur parasysh kompleksitetin e teknologjive, sasinë e pajisjeve dhe shpërndarjen gjeografike, kërkohet një menaxhim i mirëplanifikuar i shërbimeve që mbulon kontrata. OE do të jetë përgjegjës për të marrë çdo veprim të nevojshëm

për identifikimin dhe riparimin e çdo problemi për pajisjet e printimit. Për rivendosjen në funksionim të pajisjes apo funksioneve të sistemit kërkohet shërbim teknik duke siguruar ofrimin e shërbimeve të mirëmbajtjes teknike në ambjentet e KESH Sh.a nga stafi teknik i OE, Duke siguruar heqjen e pajisjeve me difekt për tu riparuar në servisin e OE duke bërë zëvendësimin e përkohshëm të pajisjes me një tjetër. Për çdo problem të raportuar, personeli i OE do të hetojë dhe të kërkojë informacion në lidhje me veprimet që janë marrë për të zgjidhur problemin.





1 (një) punonjës të certifikuar për sigurinë informatike të ndërhyrjes në sisteme : Është i nevojshëm referuar Parametrave të sigurisë. Kjo zgjidhje duhet të ofrohet nëpërmjet një platforme menaxhimi të sigurt, të ofruar nga një prodhues i njohur dhe konform të gjitha standarteve të sigurisë. Kjo platformë duhet të menaxhohet nga ofruesi i shërbimit si administrator, por gjithashtu të ofrojë mundësi menaxhimi me të drejta përdoruesi në ndërfaqe web. Duke qënë se KESH sh.a është një kompani e cila futet tek infrastrukturat kritike kërkohet që OE të ketë një person i cili të konceptojë sigurinë e sistemit sipas kërkesave të sigurisë të percaktuar nga kompania.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit/ve, të përkthyer në gjuhën shqipe në pjesët ku përcaktohen specifikimet teknike të software dhe pajisjeve objekt prokurimi, me të dhënat dhe karakteristikat teknike, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike. Katalogët duhet të jenë të verifikueshëm në website të tyre përkatës.

#### **Argumentimi:**

Kërkesa për katalogun e prodhuesit/ve, të përkthyer në gjuhën shqipe në pjesët ku përcaktohen specifikimet teknike të software dhe pajisjeve objekt prokurimi, është percaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të verifikuar përmbushjen e termave të referencës objekt prokurimi.

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ISO ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

-  **ISO 9001:2015** "Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë"
-  **ISO 14001:2015** "Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit"
-  **ISO 20000-1:2018** "Sistemi për Menaxhimin e Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit"
-  **ISO 27001:2013** "Sistemi për Menaxhimin e Sigurisë së Informacionit"

**Argumentimi:** Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

**ISO 9001:2015 "Sistemi i menaxhimit të cilësisë"**: është e nevojshme për certifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse shërbimet e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

**ISO 14001:2015 "Sistemi i Menaxhimit Mjedisor"**: është e nevojshme që OE të ketë staf të vetëdijshëm për politikën mjedisore dhe pasojat e mundshme të aktiviteteve të tyre në mjedis. Aktivitetet e OE duhet të jenë të tilla që të kontrollohet ndikimi në mjedis dhe të përgjigjet në rast emergjence të ndikimit në mjedis. Pajisjet hardware në shumicën e vendndodhjeve janë pozicionuar pranë stafit të institucionit. Për shkak të rreziqeve që sjellin substanca të dëmshme si monoksidi i karbonit nga tonerat, kërkohet që ofruesi i shërbimit të jetë i certifikuar me këtë standard.

**ISO 20000-1:2018 "Sistemi për Menaxhimin e Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit"**: është e nevojshme për menaxhimin e shërbimit të IT që përcakton kërkesat për zhvillimin, zbatimin, monitorimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e një sistemi të menaxhimit të shërbimit të IT. Referuar Termave të Referencës, citohet se: Të gjitha problemet që lindin gjatë afatit të kontratës duhet të menaxhohen dhe zgjidhen nga stafi i certifikuar i ofruesit të shërbimit. Procesi i riparimit dhe ndërhyrjes në këto pajisje brenda ambjenteve të institucionit, mbart me vete rrezikshmëri, ndaj edhe kërkohet që të mirëmenaxhohet shërbimi i servisit duke ndjekur me përpikmëri të gjitha rregullat e sigurimit teknik.

**ISO 27001:2013 "Sistemi për Menaxhimin e Sigurisë së informacionit"**: është e nevojshme pasi u ofron udhëzime për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit. Referuar Termave të Referencës citohet se: Të gjitha problemet që lindin gjatë afatit të kontratës duhet të menaxhohen dhe zgjidhen nga stafi i certifikuar i ofruesit të shërbimit. Procesi i riparimit dhe ndërhyrjes në këto pajisje brenda ambjenteve të institucionit, mbart me vete rrezikshmëri, ndaj edhe kërkohet që të mirëmenaxhohet shërbimi i servisit duke ndjekur me përpikmëri të gjitha rregullat e sigurimit teknik. OE i shërbimit duhet të ofrohet duke dokumentuar paraprakisht mënyrën e menaxhimit dhe monitorimit.

Duke qënë se KESH sh.a është një kompani e cila futet tek infrastrukturat kritike kërkohet që OE të ketë një person i cili të konceptojë sigurinë e sistemit sipas kërkesave të sigurisë të përcaktuar nga kompania. KESH sh.a është e pajisur me ISO 27001 dhe duke hyrë në strukturat kritike e ka detyrim që OE të jetë i pajisur me këtë certifikatë për të përmbushur kërkesat e sigurisë së informacionit.

Sa më sipër janë kërkuar certifikata që të vërtetojnë se ofertuesit kanë sisteme menaxhimi sipas standardeve ndërkombëtare të cilat reflektojnë dukshëm edhe në cilësinë e shërbimit. Kërkesat janë të mjaftueshme për të siguruar ofertues me kapacitete teknike cilësore të certifikuar edhe me certifikata menaxhimi të cilësisë të njohura ndërkombëtarë. Certifikatat e kërkuara për OE janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Certifikatat e kërkuara janë vendosur në përputhje me termat e referencës.

**Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

**Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike (termave të referencës):**

Korporata e zhvillon aktivitetin e saj nëpërmjet tre njësive të prodhimit (HEC Fierzë, HEC Koman, HEC Vau i Dejës) dhe personelit në zyrat e administratës qendrore, Blloku Vasil Shanto Tiranë. Personeli i administratës qendrore të KESH sh.a përbëhet kryesisht nga specialistë të nivelit drejtues, koordinativë në mbështetje të aktivitetit gjenerues nga njësitë e prodhimit, aktivitetit tregtar për shitblerjen e energjisë dhe aktiviteteve për menaxhimin dhe drejtimin e korporatës. Personeli i Njësive të prodhimit përbëhet nga administrata lokale dhe specialistë të prodhimit.

Një prej detyrave kryesore të aktivitetit të personelit të administratës qendrore KESH është përpunimi i informacionit dhe dokumentave shkresore dhe teknike në funksion të realizimit të detyrave, për rrjedhojë sistemet informatike që ndihmojnë, automatizojnë dhe përshejtojnë përpunimin e dokumentave luajnë një rol të rëndësishëm në efektivitetin dhe cilësinë e punës së punonjësve. Zhvillimi i tregut në Shqipëri ka bërë të mundur konkurimin në treg të shoqërive që ofrojnë shërbimet e sistemit të Menaxhimit të Printimit “SMP-ve” duke i ofruar pajisjet si me leasing operacional (qira) ashtu edhe me transferim pronësie (shitje). Gjithashtu zhvillimi i tregut ka bërë të mundur që operatorët ekonomike të ofrojnë paketa shërbimi për pajisjet e SMP-ve të tilla që të mundësojnë mbulimin e të gjitha kostove të përdorimit të tyre (bojë, toner, material të konsumueshem, shërbime pastrimi, mirëmbajte dhe riparimi etj).

Sistemi i Menaxhimit të Printimit duhet të sigurojë: Realizimin pa ndërprerje dhe menaxhimin proaktiv të proceseve të printimit, skanimit dhe fotokopjimit. Rritjen e shkallës së përdorimit të pajisjeve me qëllim optimizimin e punës së pajisjeve. Garantimin e një fleksibiliteti përdorimi për të gjitha pajisjet duke i organizuar ato si një flotë, ku çdo punonjës mund të aksesojë cilëndo pajisje që përdoruesi ka më afër. Të krijojë lehtësira për shpërndarjen e dokumentave që do të skanohen nga pajisjet duke i dërguar ato nga pajisja në destinacion (folder, e-mail, etj) Të ofrojë zgjidhje për kontrollin dhe monitorimin e sistemit duke siguruar të dhëna në kohë reale për funksionimin e pajisjeve, shkallën e përdorimit, gjendjen teknike të pajisjeve dhe materialeve të konsumit dhe informacionin për përdoruesit mbi sasinë e printimit dhe fotokopjimit.

## **Njësia e Prokurimit**